



REPUBLIKA E SHQIPËRIE

MINISTRIA E FINANCAVE

DREJTORIA E INSPEKTIMIT FINANCIAR PUBLIK

Nr. 2629/1 ..... Prot.

Tiranë, më 28.02:2014

Drejtuar: Ministria e Drejtësisë

**Subjekti:** Për përzgjedhjen e inspektorëve financiarë publikë

Ligji nr.10294, datë 01.07.2010 "Për inspektimin financiar publik" përcakton funksionimin e shërbimit të inspektimit financiar publik. Ky shërbim kryhet me nëpunës të administratës publike si dhe me ekspertë të jashtëm të licencuar, të cilët caktohen me urdhër të Ministrit të Financave, rast pas rasti.

Me urdhrin bashkëlidhur të Ministrit të Financave nr.32, datë 27.02.2014 "Për përzgjedhjen e inspektorëve financiarë publikë", fillon procesi i përzgjedhjes së inspektorëve financiarë publikë, të cilët do të angazhohen në misione të inspektimit financiar publik. Në këtë urdhër janë miratuar kriteret që duhet të plotësojnë aplikantët si dhe dokumentet përkatëse për aplikim.

Njësitë publike duhet të njoftojnë punonjësit e administratës së tyre dhe të strukturave vartëse për kërkesën e Ministrit të Financave, për të përzgjedhur inspektorë financiarë publikë, duke e publikuar këtë urdhër edhe në faqen e tyre të internetit.

Titullarët e organit qendror të njësisë publike dhe drejtuesit më të lartë të njësisë publike, në të cilën është punësuar nëpunësi aplikant, janë të lutur që të mbështesin personat që plotësojnë këto kriteret, për të aplikuar për të qenë inspektorë financiarë publikë.

Për sa më sipër, aplikantët për inspektorë financiarë publikë, duhet të paraqesin dokumentacionin e kërkuar brenda datës 30.04.2014 pranë Drejtorisë së Inspektimit Financiar Publik në Ministrinë e Financave, në adresën "Bulevardi Dëshmorët e Kombit, nr.3", Tiranë.

Me respekt,

GELARDINA PRODANI  
  
SEKRETAR I PËRGJITHSHËM



REPUBLIKA E SHQIPËRIË  
MINISTRIA E FINANCAVE

MINISTRI

Nr. 2629 Prot.

Tiranë, më 24 /02/2014

### URDHËR

Nr. 32 datë 27.2 2014

Për

### Përzgjedhjen e inspektorëve financiarë publikë

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës dhe nenit 6, pika 2, si dhe nenit 13, pika 1 dhe 2, të ligjit nr. 10294, datë 01.07.2010 "Për inspektimin financiar publik", Ministri i Financave

#### U r d h ë r o n :

- 1) Fillimin e procesit të përzgjedhjes së inspektorëve financiarë publikë, të cilët do të angazhohen në misionet e inspektimit financiar publik.
- 2) Kriteret që duhet të plotësojnë inspektorët financiarë publikë, janë:
  - a) Të jenë nëpunës civil,
  - b) Të kenë diplomë universitare të nivelit të dytë të studimeve ose ekuivalente me të, në shkencat ekonomike, dega financë ose kontabilitet, si dhe ato juridike.
  - c) Të ketë të paktën 5 vjet përvojë në profesion në sektorin publik,
  - d) Të mos jetë ndaluar me vendim gjykatë të formës së prerë për të ushtruar detyra dhe funksione publike;
  - e) Të lejohet nga titullari i organit qendror të njësisë publike, për të ushtruar profesionin e inspektorit financiar publik.
- 3) Për raste të veçanta që kërkojnë ekspertizë në fusha të caktuara, Ministri i Financave angazhon ekspertë të jashtëm të fushës, duke i kontraktuar si shërbim publik. Kriteret profesionale sipas fushës që kërkohet të inspektohet, do të përcaktohen nga Ministri i Financave në urdhrin e angazhimit të tyre si inspektorë financiarë publikë.
- 4) Nuk mund të ushtrojnë detyrat e inspektorit financiar publik nëpunësit e administratës publike që ushtrojnë funksionet e titullarit të njësisë publike, nëpunësit autorizues, gjyqtarët,

prokurorët, oficerët e policisë gjyqësore, audituesit e brendshëm dhe audituesit e Kontrollit të Lartë të Shtetit.

- 5) Kandidatët për inspektorë financiarë publikë, duhet të paraqesin dokumentet e mëposhtme për aplikim:
- Kërkesë me shkrim;
  - Përmbledhje e edukimit, kualifikimeve dhe eksperiencës së punës (Curriculum vitae);
  - Vërtetim nga institucioni që janë nëpunës civilë dhe miratimi nga drejtuesi më i lartë i njësisë publike për angazhimin e nëpunësit në funksione inspektimi;
  - Miratim me shkrim nga titullari i organit qendror të njësisë publike, në të cilën është punësuar nëpunësi, për lejimin për të ushtruar funksionet e inspektorit financiar publik;
  - Dokumentacionin që vërteton plotësimin e kriterëve sipas pikës 2/b, fotokopje e diplomës dhe listës së notave;
  - Dokumente që vërtetojnë kualifikime në fusha të caktuara profesionale (fotokopje);
  - Libreza e punës (Fotokopje);
  - Dëshmi penaliteti;
  - Adresën e vendbanimit, vendit të punës, dhe të dhëna kontakti (numer telefoni, adresa elektronike, etj.);
  - Fotokopje e kartës së identitetit;
  - Një fotografi (4 x 6).
- 6) Dokumentacioni paraqitet brenda datës 30.04.2014, në protokollin e Ministrisë së Financave, për Drejtorinë e inspektimit financiar publik, në adresën: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", nr. 3, Tiranë.
- 7) Procesi i përzgjedhjes së kandidatëve për inspektorë financiarë publikë, kryhet nga komisioni i ngritur për këtë qëllim nga Ministri i Financave. Komisioni shqyrton dokumentacionin e paraqitur dhe nëse gjykohet e arsyeshme, ky dokumentacion verifikohet në institucionet përgjegjëse. Komisioni harton listën e kandidatëve që plotësojnë kriteret për inspektor financiar publik, të cilën ia paraqet për miratim Ministrit të Financave, brenda afatit të caktuar prej tij. Numri maksimal i kandidatëve të përzgjedhur do të jetë 80 inspektorë financiarë publikë.
- 8) Pas miratimit të listës së inspektorëve financiarë publikë, nga Ministri i Financave lidhen marrëveshje bashkëpunimi me titullarët e njësive publike, në përputhje me paragrafin 3, të nenit 6 të ligjit të inspektimit financiar publik, sipas formatit të miratuar nga Ministri i Financave.
- 9) Ky Urdhër shpallet dhe publikohet në faqen e internetit të Ministrisë së Financave dhe u dërgohet njësive publike për publikim në faqen e tyre të internetit, si dhe për njoftim zyrtar të subjekteve të vartësisë.
- 10) Urdhri i Ministrit të Financave nr. 36, datë 16.05.2011 "Për kriteret për përzgjedhjen e inspektorëve financiarë publikë", mbetet në fuqi deri në miratimin e listës së re të inspektorëve financiarë publikë nga Ministri i Financave në zbatim të këtij urdhri.

11) Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet Drejtoria e Inspektimit Financiar Publik në Ministrinë e Financave.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

SHKËLQIM CANI



I  
I  
I  
M  
P  
S  
M  
PE  
SH  
MA  
TRA  
Spec  
Sekt  
Drejt  
Drejt